
BULETIN INFORMATIV

GUSHT 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË



**Buletin mujor i aktiviteteve të
Akademisë së Shkencave të
Shqipërisë**


Gusht, 2026

Përmbajtje

Aktivitet	4
Ndahet nga jeta akademik emeritus Mark Tirta.....	5
Lamtumirë akademik emeritues Mark Tirta! - nga e gjithë bota akademike!	7
Fjala e zëvendëskryetarit akad. Vasil Tole në ceremoninë e nderimit të akademik Mark Tirtës në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.....	11
Botime të reja	14
Botohet nga Akademia e Shkencave “Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1913), vëllimi V”	15
Botohet nga Akademia e Shkencave libri “Bajroni dhe bajronizmi në botën shqiptare”	16
Të tjera	17
Në Kyoto të Japonisë u hap Kongresi i 32-të Ndërkombëtar i Hortikulturës (IHC2026) vëllimi V”	18
Më 24 gusht 1913 u botua numri i parë i gazetës “Përlindja e Shqipëniës”	19
Akademia e Shkencave uron akademikë në ditëlindje	21
Podcast	22
Podcast AKADEMIA 9: Intervistë me akademikën Aurela Anastasi.....	23
Podcast AKADEMIA 8: Intervistë me prof. asoc. Belfjore Qose	24
In Memoriam	25
Përkujtohen personalitetet që lanë gjurmë në dijen dhe kulturën shqiptare	26

Aktivitet

Ndahet nga jeta akademik emeritus Mark Tirta



Akademia e Shkencave e Shqipërisë njofton me hidhërim të thellë se sot më 27 gusht 2026 u nda nga jeta akademik emeritus Mark Tirta, një prej studiuesve më të shquar të etnologjisë dhe antropologjisë shqiptare, një personalitet i rëndësishëm i albanologjisë dhe një nga zërat më të spikatur të studimit të trashëgimisë kulturore shqiptare.

Me largimin e tij, shkenca dhe kultura shqiptare humbasin një dijetar të përkushtuar, i cili për më shumë se gjashtë dekada ia kushtoi jetën kërkimit shkencor, dokumentimit dhe interpretimit të kulturës materiale e shpirtërore të shqiptarëve. Jeta dhe vepra e tij janë të lidhura ngushtë me përpjekjen për të njohur, ruajtur dhe përcjellë te brezat e ardhshëm pasurinë e jashtëzakonshme të traditave, besimeve, miteve, zakoneve dhe mënyrave të jetës së popullit shqiptar.

Akademik Mark Tirta lindi më 21 maj 1938 në Orosh të Mirditës. Kreu studimet e larta në degën Histori-Gjuhësi të Universitetit të Tiranës, të cilat i përfundoi në vitin 1961. Pas studimeve punoi në arsim në rrethin e Mirditës, ndërsa në vitin 1968 nisi veprimtarinë kërkimore në sektorin e etnografisë të Institutit të Historisë.

Prej vitit 1979 vijoi veprimtarinë pranë Institutit të Kulturës Popullore, ku ndërtoi një pjesë të rëndësishme të karrierës së tij shkencore. Në vitin 2008 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe

Albanologjike. Në vijim të veprimtarisë së tij të gjatë akademike e shkencore, ai mori statusin Akademik Emeritus.

Akad. Mark Tirta ishte një prej studiuesve që e njohu kulturën shqiptare jo vetëm përmes burimeve të shkruara, por edhe përmes kërkimit të drejtpërdrejtë në terren. Ai mori pjesë në ekspedita të shumta në vise të ndryshme shqiptare, duke mbledhur dhe dokumentuar dëshmi të rëndësishme mbi jetën, traditat, zakonet, besimet dhe mënyrat e organizimit të komuniteteve shqiptare. Kjo përvojë e gjerë e terrenit u bë një prej veçorive dalluese të punës së tij shkencore.

Puna e tij kërkimore ishte e shumëanshme dhe preku disa nga çështjet themelore të etnologjisë shqiptare. Ai u mor në mënyrë të veçantë me migrimet e popullsisë shqiptare dhe mitologjinë popullore, gjithashtu studimet e tij u shtrinë edhe në aspektet e familjes, veshjeve popullore, së drejtës zakonore, toponimisë e antroponimisë, artit popullor, historisë së etnologjisë shqiptare dhe personaliteteve të kësaj fushe.

Trashëgimia e tij bibliografike është e jashtëzakonshme. Ai la pas një trashëgimi të gjerë studimore. Ka botuar mbi 300 punime shkencore e kulturore, ka marrë pjesë me mbi 100 kumtesa në sesione shkencore, simpoziume, konferenca dhe kongrese shkencore kombëtare e ndërkombëtare, ndërsa rreth 42 punime të tij janë botuar në gjuhë të huaja. Ndër veprat e tij më të rëndësishme janë “Mitologjia ndër shqiptarë” 2004, “Etnologjia e shqiptarëve” 2003, 2006, “Etnologjia e përgjithshme” 2001, 2008, “Migrime të shqiptarëve” 1999, “Mjeshtëria e kërkimit shkencor në etnologji” 2006, “Panteoni e simbolika, doke e kode...” 2007 dhe “Lëvizjet migruese të shqiptarëve, të brendshme e në popujt më afër” 2013.

Në historinë e studimeve shqiptare, akademik Mark Tirta do të kujtohet si një prej dijetarëve që i dha një dimension të rëndësishëm shkencor studimit të kulturës tradicionale shqiptare. Ai e pa etnologjinë jo vetëm si një fushë të mbledhjes dhe përshkrimit të fakteve, por si një mënyrë për të kuptuar historinë, kujtesën, identitetin dhe vazhdimësinë kulturore të shqiptarëve. Përmes punës së tij, shumë dëshmi të kulturës materiale dhe shpirtërore shqiptare u dokumentuan dhe u bënë pjesë e kujtesës së shkruar shkencore.

Librat, studimet dhe materialet që la pas përbëjnë një pasuri të çmuar për studiuesit e sotëm dhe të ardhshëm të etnologjisë, antropologjisë, folklorit, historisë së kulturës dhe albanologjisë.

Me ndarjen e tij nga jeta, Akademia e Shkencave e Shqipërisë humbet një nga figurat e saj të shquara, ndërsa shkenca shqiptare humbet një studiues që i kushtoi gjithë jetën njohjes së rrënjëve kulturore të shqiptarëve.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë u shpreh ngushëllimet më të thella familjes, të afërmeve, miqve, kolegëve dhe gjithë bashkësisë shkencore për këtë humbje të rëndë.

I paharruar kujtimi i Akademik Emeritus Mark Tirta!

Lamtumirë akademik emeritues Mark Tirta! - nga e gjithë bota akademike!



- U zhvillua sot ceremoni solemne në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për t'i dhënë lamtumirën akademikut Tirta.

Në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u organizua sot më 28 gusht 2026 ceremoni solemne për t'i dhënë lamtumirën në emër të gjithë botës akademike shqiptare akademikut emeritues Mark Tirta.

Të pranishëm ishin zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole, sekretarja shkencore, akad. Anila Hoda, anëtarë të Kryesisë së Akademisë së Shkencave, familjarë, miq dhe bashkëpuntorë të të ndjerit.

Ceremonia u hap me fjalën e sekretares shkencore, akad. Anila Hoda, e cila ftoi të pranishmit të mbanin një minutë heshtje në nderim të kujtimit të akademikut të shquar. Në fjalën hapëse akad. Hoda u shpreh se në këtë moment të dhimbshëm pjesëmarrësit janë mbledhur për të zhvilluar ceremoninë solemne të përcjelljes dhe për të nderuar jetën, veprën e kujtimin e akademik Mark Tirtës, një prej studiuesve më të shquar të etnologjisë dhe antropologjisë shqiptare. Ajo theksoi se kjo ceremoni zhvillohet në përputhje me rregulloren për ceremonitë zyrtare të Akademisë së Shkencave për të shprehur mirënjohjen ndaj kontributit të tij të jashtëzakonshëm, duke shtuar se për më shumë se gjashtë dekada akademik Tirta ia kushtoi jetën kërkimit, dokumentimit dhe interpretimit të kulturës materiale e shpirtërore të shqiptarëve nëpërmjet ekspeditave dhe kërkimit në terren.

Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole, vlerësoi lart

figurën e akademikut Tirta. Ai u shpreh se, përveçse etnolog, akad. Mark Tirta ishte mbledhës, dokumentues dhe interpretues i trashëgimisë, njeriu i bibliotekave dhe i terrenit që i dha kujtesë shkencore një pjese të madhe të trashëgimisë që rrezikonte të humbiste. Ai ka lënë gjurmë të thella në studimet e etnosit shqiptar, nga rrënjët deri te mitet dhe ritet, duke e parë kulturën popullore jo si relike, por si kujtesë të gjallë të shoqërisë.

Akad. Toke në fjalën e tij vuri në dukje se vepra e tij shquhet për përpjekjen jo vetëm për të regjistruar, por edhe për të kuptuar thellësisht zakonet, besimet dhe mënyrën e jetuarit, duke punuar me dhembshuri dhe dashuri për të shpëtuar trashëgiminë nga rreziku i urbanizimit të shpejtë.

Ai shtoi se puna e tij mbart një përparësi të veçantë, të dëgjojë përpara se zëri të shuhet, të regjistrojë para se kujtimi të venitet dhe të interpretojë para se dukuritë të bëhen të pakuptueshme.



Përtej kontributit shkencor, akademik Mark Tirta do të mbahet mend si intelektual i ndërtuar autoritetin përmes punës, njeriu që pas çdo të dhëne etnologjike shihte një njeri, familje dhe histori, si dhe pedagogu që përcolli dijen te brezat e rinj.

Kryetari i Komisionit të Përhershëm të Antropologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore, z. Artan Shkreli, në fjalën e tij në nderim të ndarjes nga jeta të akademik Mark Tirtës, theksoi se ka qenë një personazh i jashtëzakonshëm dhe i njohur gjerësisht, qoftë përmes shkrimeve të tij, qoftë nga studimet e bëra në terren në malësitë e Veriut të Shqipërisë dhe Kosovës. Ai vlerësoi se Tirta studioi një kulturë materiale unike që i përkiste ilirëve të veriut dhe zonave keltike, duke hapur një faqe të re e të paeksploruar në antropologji dhe disiplina kufitare me kureshtje dhe skrupolozitet të lartë.

Më tej, z. Shkreli u ndal te sfidat e promovimit dhe transmetimit të kësaj pasurie shkencore, duke vënë në dukje se, pavarësisht kontributit të tij të madh, vepra e Markut mungon në internet dhe kërkon kërkime të thella në biblioteka, ndërsa theksoi se misioni i Akademisë është pikërisht përcjellja e dijes dhe kuptueshmërisë të njerëzimit të zakonshëm. Drejtori i Institutit të Antropologjisë, prof. asoc. dr. Olsi Lekaj, theksoi se akademik Mark Tirta ishte një nga personalitetet më të shquara të etnografisë dhe albanologjisë shqiptare, si dhe pionier në studimin e traditave, mitologjisë dhe besimeve popullore edhe në perioda ideologjike të pafavorshme.



Në vijim të homazheve prof. dr. Perikli Qirjazi solli në vëmendje peshën e pazëvendësueshme të trashëgimisë shkencore të lënë nga studiuesi, duke u shpreh se vepra e tij mbetet një kontribut i pazëvendësueshëm që ndihmon shqiptarët të njohin rrënjët dhe trashëgiminë e tyre shpirtërore.

Në mbyllje ai u shpreh se kontributi i tij nuk shuhet me vdekjen, por jeton përgjithmonë në libra, arkiva, institucione kërkimore dhe në kujtesën e atyre që ai orientoi.

Në vijim, kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, akad. Gëzim Hoxha, mbajti fjalën e lamtumirës në emër të seksionit, duke e vlerësuar atë si një formues brezash përmes tekstit universitar "Etnologjia e përgjithshme" dhe kontributit të tij në muzeologji, projekte ndërkombëtare e bashkëpunimin me UNESCO-n. Ai e cilësoi anëtarësimin e tij në Akademi në vitin 2008 si një vlerësim të merituar për një jetë kushtuar dijes.

Sot, ndërsa përcjellim akademik Mark Tirtën në banesën e fundit, ndjejmë jo vetëm dhimbjen e thellë të humbjes, por mbi të gjitha krenarinë e madhe që shkenca shqiptare pati në gjirin e saj një personalitet të këtyre përmasave. Veprat e tij do të vazhdojnë të jenë përherë burim i pashtershëm frymëzimi, ku do të jetojë përgjithmonë mendimi i tij shkencor dhe dashuria e tij e pashtershme për kulturën shqiptare, u shpreh akad. Hoxha. Në emër të familjes, vajza e të ndjerit shprehu mirënjohjen e saj për Akademinë e Shkencave, duke sjellë në vëmendje dy dimensionet e ndritura të babait të saj, përkushtimin e jashtëzakonshëm si studiues dhe model i pazëvendësueshëm për brezat, dhe ngrohtësinë si njeri familjar, trashëgimi krenarie që fëmijët dhe nipërit do ta vazhdojnë me të njëjtin pasion.

Fjala e zëvendëskryetarit akad. Vasil Tole në ceremoninë e nderimit të akademik Mark Tirtës në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



-Akademik Mark Tirta ishte njeri i bibliotekave, i terrenit, i kabinetit dhe i ekspeditave.

Sot Akademia e Shkencave humbi një nga njohësit më të thellë të kulturës popullore shqiptare: etnograf, etnolog, antropolog; njohës dhe studiues i miteve dhe riteve të hershme e të kryehershme shqiptare; anëtar i Asamblesë së saj, akademik emeritus Mark Tirta.

Akademik Mark Tirta ishte një përfaqësues i vyer i shkollës vendëse të etnografisë, etnologjisë dhe antropologjisë. Jeta e tij është e përmbushur me kërkime serioze e të citueshme për mitet dhe mitologjinë shqiptare, duke u shtrirë me sukses edhe në fusha të tjera të afërta, si trashëgimia etnojuridike e etnozakonore, besimet dhe besëtytnitë, deri tek trashëgimia e hershme në emërtime.

Gjithnjë mendje e mprehtë dhe kritike, i dashuruar me traditën dhe njëherazi avokat i saj, akad. Mark Tirta, përveçse etnolog, ishte edhe mbledhës, dokumentues dhe interpretues i trashëgimisë.

Akad. Mark Tirta ishte njeri i bibliotekave dhe i terrenit, i kabinetit dhe i ekspeditave. Kultura popullore nuk ishte për të një çështje vetëm akademike apo një tërësi përkufizimesh teorike. Ai i dha kujtesë shkencore një pjese të madhe të trashëgimisë që rrezikonte të humbiste; ai mblodhi gjurmët e një bote që po largohej.

Falë kërkimeve të tij, sot kemi burime të shfrytëzueshme në libra dhe, sidomos, në arkivat e pasura që ruhen në Institutin e Antropologjisë.

Në përbërje të një skuadre studiuesish të një brezi që ndoshta nuk i kthehet më shkencës shqiptare, si Rrok Zojzi e Andromaqi Gjergji, akademik Mark Tirta ka lënë gjurmë të thella në studimet për etnosin shqiptar, që nga rrënjët e tij, deri te epoka e heronjve kulturorë dhe miteve sakrale. Sa herë që një studiues shqiptar apo një albanolog do të kërkojë të kuptojë një besim, rit apo mit të trashëguar, do të gjendet përpara portës së dijes dhe gjurmës kërkuese të akad. Mark Tirtës.

Ai ishte nga ata dijetarë që nuk e panë kulturën popullore si një relike të së shkuarës, por si një kujtesë të gjallë të një shoqërie. Për të, miti, besimi, riti, zakoni, simboli, gojëdhëna, mënyra e të jetuarit dhe mënyra e të menduarit të njerëzve përbënin pjesë të një sistemi të ndërlikuar, nëpërmjet të cilit mund të ndiqeshin gjurmët e historisë së gjatë të shqiptarëve. Kjo është një nga meritat e mëdha të veprës së tij: ai nuk u mjaftua të regjistronte trashëgiminë. Ai kërkoi ta kuptonte atë.

Në një kohë kur shumë prej formave tradicionale të jetës shqiptare po ndryshonin me shpejtësi, puna e tij mori edhe vlerën e një modeli të gjurmuesit të zellshëm, që punoi me dhimbsuri për trashëgiminë gojore dhe i dashuruar e i frymëzuar prej saj, ngulmues për të shpëtuar nga harrimi pjesë të saj, të rrezikuara nga urbanizimi i shpejtë. Ai i kërkoi ato dëshmi në terren, në kujtesën e njerëzve, në traditat lokale dhe në rrëfimet e trashëguara brez pas brezi. Aty ku dikush tjetër mund të shihte vetëm një zakon të vjetër, ai kërkonte kuptimin, prejardhjen, funksionin dhe vijimësinë e tij. Prandaj vepra e tij nuk është vetëm një pasuri e etnologjisë, por edhe një pjesë e kujtesës kulturore shqiptare.

Akad. Mark Tirta i përkiste një brezi studiuesish për të cilët puna shkencore kërkonte durim, përkushtim dhe një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me burimin. Në studimet e tij mbi kulturën tradicionale, ai u përpoq të depërtonte përtej sipërfaqes së dukurive.

Kërkoi lidhjet ndërmjet tyre, shtresëzimet historike, marrëdhëniet me hapësirën ballkanike dhe evropiane, por edhe veçantinë e përvojës shqiptare.

Një pjesë e rëndësishme e veprës së tij mund të lexohet si një përpjekje për të rindërtuar mënyrën se si shqiptarët e kanë kuptuar botën përreth tyre: natyrën, të mbinatyrshmen, jetën dhe vdekjen, fatin, familjen, komunitetin dhe marrëdhënien me të shkuarën. Dhe kujtesa është një nga format më të brishta të ekzistencës së një populli. Ajo mund të humbasë jo vetëm kur shkatërrohen dokumentet, por edhe kur humbin fjalët, rrëfimet, ritualet dhe njerëzit që i kanë mbajtur ato gjallë. Prandaj puna e etnologut ka një përgjegjësi të veçantë: të dëgjojë përpara se zëri të shuhet, të regjistrojë përpara se kujtimi të venitet dhe të interpretojë përpara se një dukuri të bëhet e pakuptueshme për brezat që vijnë.

Akademik Mark Tirta e përmbushi këtë përgjegjësi me një këmbëngulje të rrallë. Përtej veprës shkencore, në kujtesën e atyre që e njohën do të mbetet edhe njeriu: studiuesi që e kishte përkushtuar jetën ndaj një fushe që shpesh kërkon më shumë durim sesa lavdi;

intelektuali që e ndërtoi autoritetin jo përmes zhurmës, por përmes punës; njeriu i shkencës që e dinte se pas një të dhëne etnologjike qëndronte një njeri, një familje, një bashkësi dhe një histori; pedagogu që përcillte dijen dhe trashëgiminë kulturore tek brezat e rinj. Kjo e bën humbjen e tij edhe më të ndjeshme.

Në një tjetër moment të rëndësishëm të jetës së tij akademike, Mark Tirta u pranua si anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në një kohë kur vetë Akademia po kërkonte një stad të ri të zhvillimit të saj. Ai e kuptoi këtë nevojë dhe e mbështeti procesin e reformimit të saj, duke e parë Akademinë jo thjesht si një institucion të trashëguar, por si një institucion që duhej të përtërihej, të forconte dimensionin e saj kërkimor dhe të fitonte një rol akoma më aktiv në jetën shkencore e kulturore të vendit. Reforma që ndërmorëm së bashku krijoi kushtet për këtë stad të ri dhe Mark Tirta, me maturinë dhe autoritetin e tij shkencor, ishte pjesë e kësaj përpjekjeje për një Akademi më bashkëkohore, më të hapur dhe më të lidhur me zhvillimin e shkencës shqiptare. Me akademik Mark Tirtën largohet një dëshmitar i një epoke të studimit të kulturës shqiptare; një njeri që e kaloi një pjesë të rëndësishme të jetës duke mbledhur, sistemuar dhe shpjeguar gjurmët e një trashëgimie që, pa punën e tij dhe të studiuesve të brezit të tij, do të ishte sot shumë më e varfër në dokumentim dhe në kuptim.

Brezi i ardhshëm mund të mos e njohë zërin e tij, mënyrën e tij të folurit apo praninë e tij në mjediset ku zhvillohej jeta shkencore. Por do të njohë pyetjet që ai shtroi dhe burimet që ai la. Do të ndeshet me emrin e tij në studimet e etnologjisë shqiptare dhe do të kuptojë se pas atij emri qëndron një punë e gjatë, e heshtur dhe e palodhur.

Kjo është ndoshta forma më e qëndrueshme e meritave të një studiuesi: jo monumenti prej guri, por libri; jo lavdia e çastit, por kujtesa e brezave; jo zhurma rreth emrit, por dobia e veprës.

Nderimi më i mirë që mund t'i bëhet sot nuk është vetëm të flasim për humbjen e tij, por të vazhdojmë të lexojmë, të përdorim dhe të çojmë më tej atë që ai kërkoi gjatë gjithë jetës: njohjen e kulturës shqiptare në thellësinë, larminë dhe kompleksitetin e saj. Sepse sa herë që një studiues do të kërkojë të kuptojë një besim të vjetër, një rit, një mit, një zakon apo një simbol të trashëguar, do të ndeshet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, me punën e Mark Tirtës. Dhe atëherë ai nuk do të jetë më vetëm një emër i së shkuarës. Do të jetë përsëri i pranishëm: në librat e tij, në kujtesën e kulturës që studioi, në pyetjet që la pas dhe, mbi të gjitha, në atë pjesë të identitetit shqiptar që ai pati durimin, dijen dhe përkushtimin ta kërkonte e ta ruante.

Prehu në paqe, i dashur dhe i paharruar Mark. Vepra jote qoftë e gjallë dhe kujtimi yt i përhershëm në brezat që do të vijnë.

Botime të reja

Botohet nga Akademia e Shkencave “Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1913), vëllimi V”



Në këtë vëllim, Marenglen Verli, Armend Mehmeti dhe Jorina Verli sjellin dokumentet e muajit tetor 1913, të cilat përmbajnë të dhëna me interes për ngjarje që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, lidhen me zhvillimet ndërkombëtare, lidhen me zhvillimet pas Konferencës së Ambasadorëve në Londër dhe pas dy Luftërave Ballkanike.

Dokumentet pasqyrojnë kryesisht reagimin e shteteve fqinje që këmbëngulnin në pretendimet e tyre territoriale dhe nuk linin gur pa lëvizur kundër shtetit të ri shqiptar.

Në këtë kuadër jepen informacione interesante për shqetësimin dhe ankthin, veçanërisht në elitën politike shqiptare, në pritje të veprimeve konkrete të përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha për përcaktimin në terren të kufijve të Shqipërisë. Gjithashtu në vëllim trajtohen luhatjet e Vidit për të pranuar kurorën e Principatës Shqiptare, të krijimit dhe përcaktimit të kompetencave të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, si dhe problemet që lidheshin me oficerët holandezë që do të krijonin xhandarmërinë e shtetit shqiptar etj.

Në konstelacionin e zhvillimeve politike dhe ushtarake të kohës lëvrijnë edhe një mori personalitetesh politike shqiptare dhe të huaja të niveleve të ndryshme.

Viti: 2026

Faqe: 767

ISBN: 9789928855954

Botohet nga Akademia e Shkencave libri “Bajroni dhe bajronizmi në botën shqiptare”



-Përgatiti: prof. as. dr. Evalda Paci

Në këtë përmbledhje aktesh e kontributesh të paraqitura në konferencën shkencore kushtuar Lord Bajronit, në 200-vjetorin e ndarjes nga jeta, mbajtur më 8 korrik 2024 pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, janë përfshirë një sërë trajtesash që reflektojnë mbi të gjitha dimensionet e njohjes dhe të receptimit të veprës së këtij autori.

Kontributet e përfshira në aktet e botimit të kësaj konference synojnë të pasurojnë profilin njohës rreth këtij autori, i cili, i lidhur ngushtë me prirjet e kohës në të cilën jetoi e krijoi, shkroi edhe për “bijtë e shqipes”, duke përjetësuar me vargje kujtesën mbi trimërinë shqiptare dhe tiparet burrërore të saj.

Figura dhe personaliteti i Bajronit ndeshen të pasqyruara edhe në vepra të artit, fakt që trajtohet në kontributin “Bajroni, frymëzues i temës shqiptare në art” nga prof. Ferid Hudhri.

Prurje të vyera vihen re edhe në kontekst të trajtimit të bajronizmit si prirje dhe orientim i reflektuar në disa areale të zhvillimeve europiane.

Viti: 2026

Faqe: 269

ISBN: 9789928873033

Të tjera

Në Kyoto të Japonisë u hap Kongresi i 32-të Ndërkombëtar i Hortikulturës (IHC2026) vëllimi V"



Kongresi do të zhvillohet deri më 28 gusht 2026 me pjesëmarrjen e studiuesve, akademikëve, ekspertëve dhe profesionistëve nga vende të ndryshme të botës. Në këtë veprimtari të rëndësishme akad. Nazim S. Gruda, anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ka një rol të veçantë dhe angazhim në disa nivele. Ai është anëtar i Komitetit Shkencor të IHC2026, si dhe anëtar i Komitetit Shkencor të Simpoziumit S14, me temë “International Symposium on Evaluating the Impact and Scaling of Innovations for Sustainable Horticulture” – Simpoziumi ndërkombëtar për vlerësimin e ndikimit dhe shtrirjen e inovacioneve për një hortikulturë të qëndrueshme. Akad. Gruda do të jetë ligjërues kryesor dhe do të drejtojë një sesion shkencor, duke sjellë në këtë forum ndërkombëtar përvojën dhe ekspertizën e tij në fushën e sistemeve inovative dhe të qëndrueshme të prodhimit hortikulturor.

Një zhvillim tjetër me rëndësi pritet gjatë punimeve të Kongresit: konfirmimi i akad. Grudës si Kryetar i Seksionit të Hortikulturës në Mjedise të Mbrojtura (Greenhouse and Indoor Production Horticulture) të ISHS-së, për mandatin e ardhshëm katërvjeçar. Pjesëmarrja dhe angazhimi në këto struktura shkencore dhe drejtuese përbën një vlerësim të rëndësishëm të kontributit të tij në shkencën ndërkombëtare të hortikulturës dhe një përfaqësim të spikatur të Akademisë në një nga forumet më të rëndësishme botërore të kësaj fushe.

IHC2026 zhvillohet nën kujdesin e Shoqatës Ndërkombëtare për Shkencën e Hortikulturës (ISHS – International Society for Horticultural Science), organizata ndërkombëtare që bashkon komunitetin shkencor të hortikulturës dhe nxit kërkimin, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e njohurive në këtë fushë.

“Përlindja e Shqipëniës” botohej dy herë në javë, në Vlorë, dhe në faqet e saj u botuan jo

vetëm shkrime politike, shoqërore e kulturore, por edhe akte e ligje të Qeverisë së Vlorës. Përmes kryeartikujve dhe shkrimeve të saj, gazeta mbrojti interesat kombëtare dhe të drejtat e shqiptarëve, duke pasqyruar edhe ngjarjet dramatike që po përjetonin trojet shqiptare të mbetura jashtë kufijve të shtetit të pavarur.

Gazeta vijoi botimin deri më 28 mars 1914, duke lënë pas 56 numra dhe një dëshmi të çmuar të periudhës së parë të shtetit shqiptar. Ajo konsiderohet edhe pararendëse e “Fletores Zyrtare”.

“Përlindja e Shqipëniës” mbetet një nga dëshmitë më të rëndësishme të publicistikës shqiptare në vitet e para të Pavarësisë dhe të përpjekjeve për ndërtimin e shtetit shqiptar.

Akademia e Shkencave uron akademikë në ditëlindje

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë ka përcjellë urimet e saj me rastin e ditëlindjeve të disa prej personaliteteve të shquara të komunitetit akademik, shkencor dhe të jetës publike shqiptare.

Në këtë kuadër, urime të përzemërta i janë drejtuar akademikut Nestor Thereska, akademikut emeritus Rexhep Meidani, akademikes Rajmonda Bualoti, akademikut Kosta Barjaba dhe akademikut Pëllumb Xhufi.

Në mesazhet e urimit, Kryesia e Akademisë së Shkencave ka vlerësuar kontributet e rëndësishme të këtyre personaliteteve në fushën e kërkimit shkencor, arsimit të lartë, kulturës dhe jetës publike shqiptare. Njëkohësisht, atyre u janë përcjellë urimet më të mira për shëndet, jetë të gjatë, mbarësi dhe vijimësi të suksesshme të veprimtarisë së tyre akademike, shkencore dhe profesionale.

Përmes këtyre urimeve, Akademia e Shkencave të Shqipërisë shpreh vlerësimin institucional për kontributin e gjithsecilit prej tyre në zhvillimin dhe pasurimin e mendimit shkencor shqiptar, si dhe në forcimin e rolit të dijes dhe ekspertizës akademike në shoqërinë shqiptare.

Në këtë ditë të veçantë, Akademia u përcjell akademikëve dhe personaliteteve të nderuara urimet më të mira për ditëlindjen, duke u dëshiruar shëndet, mbarësi dhe suksese të mëtejshme në veprimtarinë e tyre shkencore, akademike dhe shoqërore.

Podcast

Podcast AKADEMIA 9: Intervistë me akademiken Aurela Anastasi




Në episodin e nëntë të “Podcast Akademia”, e ftuar është akademike Aurela Anastasi, Kryetare e Komisionit të Shkencave Juridike dhe Sociale pranë Akademisë së Shkencave. Me akademiken Anastasi bisedojmë për rolin e gruas në shkencë, kontributin e grave në zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri, si edhe për sfidat dhe perspektivat që i presin brezat e rinj.

Ajo ndan përvojën e saj mbi fillimet e karrierës akademike, sfidat e rrugëtimit profesional dhe rëndësinë e nxitjes dhe mbështetjes së vajzave të reja për të zgjedhur një karrierë në shkencë.

Për më shumë shikoni linkun: <https://youtu.be/JNE0xIKpBiA?si=Oyji7nlcPWVUdioI>



Podcast AKADEMIA 8: Intervistë me prof. asoc. Belfjore Qose



Në episodin e tetë, e ftuar në “Podcast Akademia” është kryetarja e Akademisë së të Rinjve, prof. asoc. Belfjore Qose, me të cilën bisedojmë për rolin e Akademisë së të Rinjve në zhvillimin e kërkimit shkencor, mbështetjen e studiuesve të rinj dhe nxitjen e një brezi të ri kërkuesish të përkushtuar ndaj shkencës.

Gjatë këtij episodi trajtohet rrugëtimi i Akademisë së të Rinjve, mundësitë konkrete që ajo u ofron kërkuesve të rinj, cilësitë, sfidat dhe vizioni që duhet të karakterizojë brezin e ri të studiuesve.

Për më shumë shikoni linkun: <https://www.youtube.com/watch?v=lsSpbz020Y0>



In Memoriam

Përkujtohen personalitetet që lanë gjurmë në dijen dhe kulturën shqiptare

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në kuadër të veprimtarisë së saj institucionale vijon të botojë materiale përkujtimore kushtuar personaliteteve të shquara të shkencës, arsimit, kulturës, artit dhe jetës kombëtare shqiptare. Përmes këtyre botimeve, Akademia evidenton kontributet e figurave që kanë pasur rol të rëndësishëm në zhvillimin e mendimit shkencor, të arsimit, të kulturës dhe të vetëdijes kombëtare shqiptare.

Materialet publikohen në përputhje me datat përkatëse të lindjes ose të ndarjes nga jeta dhe përbëjnë një formë të rëndësishme të vlerësimit institucional të veprës dhe kontributit të personaliteteve të shquara. Në këtë kuadër janë përfshirë figura të periudhave dhe fushave të ndryshme të jetës shqiptare, duke dëshmuar larminë e kontributeve në formësimin e zhvillimit intelektual, shkencor dhe kulturor të vendit.

Ndër personalitetet e përfshira në këtë veprimtari janë arsimtarja dhe atdhetarja e shquar Sevasti Qiriazi Dako, akademiku dhe ish-kryetari i Akademisë së Shkencave Shaban Demiraj, arkeologu i shquar Frano Prendi, si dhe Nënë Tereza, figurë me përmasa të veçanta në historinë shqiptare dhe me jehonë të gjerë ndërkombëtare.

Një vend të rëndësishëm zënë edhe personalitetet e letërsisë, arkeologjisë, gjuhësisë dhe mjekësisë. Në këtë kuadër janë trajtuar jeta dhe vepra e shkrimtarit Migjeni, kontributi i njërës prej themeluesve të arkeologjisë shqiptare, Hasan Cekës, si dhe veprimtaria e albanologes së shquar Agnia Vasiljevna Desnickaja, akademikut Bahri Beci, akademikut dhe mjekut të shquar Ylli Popa dhe kompozitorit të njohur Çesk Zadeja.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe personaliteteve që kanë dhënë kontribute të rëndësishme në zhvillimin e arteve dhe të kulturës shqiptare. Në këtë grup përfshihen Kolë Idromeno, piktor, fotograf dhe arkitekt, si dhe shkrimtarja Musine Kokalari, veprimtaria dhe krijimtaria e së cilës përbëjnë pjesë të rëndësishme të historisë së kulturës dhe letërsisë shqiptare. Në fushën e shkencave albanologjike, mjekësisë dhe studimeve historike e kulturore, janë përfshirë gjithashtu akademiku dhe kirurgu i shquar Petrit Gaçe, gjuhëtari dhe albanologu Eqrem Çabej, akademiku Kolë Popa, si dhe ballkanologu dhe albanologu francez Louis Auguste Henri Dozon.

Përmes përfshirjes së këtyre figurave, veprimtaria përkujtimore e Akademisë shtrihet edhe përtej kufijve të hapësirës akademike shqiptare, duke evidentuar kontributet e studiuesve të huaj në njohjen dhe studimin e gjuhës, historisë dhe kulturës shqiptare.